



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR  
GJYKATËN KUSHTETUESE TË KOSOVËS  
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

**Prishtinë, maj 2019**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Shemsije Llugiqi (Udhëheqëse e ekipit) dhe Selvete Foniqi (Anëtare e ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Shkëlqim Xhema.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	10
4 Qeverisja e mirë.....	16
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	17
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	19
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	21

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për vitin 2018, i cili përfshinë Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 23/11/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


#### Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

## Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



## Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të GJKK-së gjatë procesit të auditimit.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

#### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

#### Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Sekretari i Përgjithshëm dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të GJKK-së.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-të do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

---

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga GJKK-ja kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK); dhe
- Plani i Prokurimit për vitin 2018.

Në kontekst të PFV-ve, kemi identifikuar mangësinë si në vijim:

Te neni 19 - Raporti për pasuritë jo financiare - pasuritë nën 1,000€ ishin nënvlerësuar për vlerën 31,288€, këto pasuri ishin shpalosur në PFV në vlerë 34,313€ të cilat kishin përfshirë vetëm pasurinë e vitit 2018. Ndërsa vlera e saktë e këtyre pasurive ishte 65,601€.

Pasuria e viteve paraprake nuk ishte përfshirë në vlerën e raportimit në PFV, pasi që sistemi e-pasuria nuk kishte bërë zhvlerësimin e tyre, me përjashtim të vitit 2018. Lidhur me këtë, GJKK-ja kishte kërkuar nga MAP-i të bëjë zhvlerësimin e gjithë pasurive në regjistrin e e-pasurisë për të paraqitur gjendjen e saktë në PFV, mirëpo kjo e fundit zhvlerësimin e kishte bërë pas dorëzimit të PFV-ve duke rezultuar me vlerë tjetër të gjendjes së pasurisë.

Në kontekst të PFV-ve dhe kërkesave tjera për raportim të jashtëm, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi. Marrë parasysh çka u tha më lart, me përjashtim të çështjes së pasurisë nën 1,000€, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me rastin e dorëzimit të PVF-ve në MF, konsiderohet e saktë dhe e drejtë.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

**Rekomandimi C1** Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që me rastin e prezantimit të pasurive jo kapitale nën 1,000€ në PFV-të, përfshihet vlera totale e pasurive të saj duke u siguruar se janë aplikuar normat e zhvlerësimit për të gjitha vitet. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj pasqyrave financiare vjetore janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë si dhe detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në përgjithësi GJKK ka kontrolle të duhura në raport me obligimet e saj ligjore. Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkojnë procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës të cilët sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve, rregulloreve të brendshme dhe proceseve tjera të kontrollit.

Megjithatë, ne kemi vërejtur dobësi në planifikimin dhe klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve, në kompensimin e shtesave gjatë pushimit të lehonisë si dhe mangësi në azhurnimin e kontratave.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>1,862,538</b>	<b>1,698,814</b>	<b>1,697,491</b>	<b>1,527,569</b>	<b>1,445,956</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,862,538	1,698,780	1,697,491	1,505,146	1,445,956
Donacionet e jashtme	-	34	-	22,423	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 163,724€ me vendim Nr.07/80 për kursime buxhetore.<sup>2</sup>

Në vitin 2018 GJKK ka shpenzuar 1,697,491€ apo 99% të buxhetit final. Krahasuar me vitin 2017, kishte realizim të njëjtë, që do të thotë se realizimi i buxhetit ishte në nivel të kënaqshëm.

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave;

<sup>2</sup> Shkresa e dërguar nga Ministri i Financave për deklarimin e kursimeve buxhetore nëpër kategori ekonomike.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>1,862,538</b>	<b>1,698,814</b>	<b>1,697,491</b>	<b>1,527,569</b>	<b>1,445,956</b>
Pagat dhe Mëditjet	1,181,836	1,137,867	1,137,867	998,706	955,389
Mallrat dhe Shërbimet	491,702	512,236	512,184	500,301	485,537
Shërbimet komunale	4,000	3,500	3,246	3,562	2,498
Investimet Kapitale	185,000	45,211	44,195	25,000	2,532

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur:

- Buxheti final për kategorinë paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 43,969€. Këto mjete janë deklaruar kursime pas dorëheqjes së dy këshilltarëve, një pezullimi të këshilltarit dhe një pozitë e planifikuar për këshilltar juridik që ishte në proces të rekrutimit. Realizimi i buxhetit ishte 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 20,534€ me vendim të Qeverisë Nr.07/80 të dt. 18.12.2018. Në këtë kategori realizimi ishte afër 100%;
- Buxheti final te kategoria e shërbimeve komunale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 500€, ndërsa realizimi ishte 93%e buxhetit final; dhe
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte reduktuar në vlerë prej 139,789€ 3për kursime të deklaruara. Këto kursime nga GJKK kishin të bëjnë për projektet kapitale të porealizuara në vitin 2018, siç ishin: projekti “ Renovimi i objektit të GJKK-së” në shumë 100,000€, i bartur për vitin 2019, për shkak se ishte në pritje të sigurimit të lejes për renovim nga Komuna e Prishtinës, projekti për blerjen e veturave në shumën 30,000€ i cili nuk ishte realizuar për shkak të vonesës në procedurat e tenderit që zhvillohen nga AQP-ja, si dhe kursimet e deklaruara në vlerë 9,834€ (mjete të mbetura nga projektet tjera të realizuara). Në këtë kategori realizimi i buxhetit ishte 98%.

<sup>3</sup> Deklarimi i kursimeve buxhetore nga GJKK me dt.01.10.2018 Nr.ref.SP-1461/18/mv.

---

Gjatë testimit kemi identifikuar si në vijim:

---

### Çështja A1<sup>4</sup> – Planifikim dhe klasifikim joadekuat i shpenzimeve

**Gjetja** Sipas planit kontabël shpenzimet klasifikohen me kode të ndara. Pajisje të IT-së mbi 1,000€ janë të kategorizuara si investime kapitale, ndërsa pajisjet nën 1,000€ janë të kategorizuara në mallra dhe shërbime.

Nga kategoria e investimeve kapitale janë shpenzuar 14,485€<sup>5</sup> për furnizime me pajisje të IT-së. Pajisjet janë kontraktuar më vlerë nën 1,000€, që në këtë rast do të duhej të planifikohej dhe shpenzohej buxheti nga kategoria për mallra dhe shërbime.

Shpenzimi nga kategoria e investimeve kapitale ka ndodhur, për shkak se në Ligjin e buxhetit për vitin 2018, furnizimet me pajisje të IT-së ishin planifikuar si projekte kapitale, mirëpo gjatë procesit të prokurimit janë ofertuar dhe kontraktuar me çmime më të lira së 1,000€ për disa nga artikujt e planifikuar më parë.

**Rreziku** Planifikimi jo i duhur i shpenzimit nga kategoria e investimeve kapitale që i përket mallrave dhe shërbimeve, ndikon në klasifikimin jo adekuat apo mbivlerësimin e investimeve kapitale ndërsa në anën tjetër nënvlerësimin e mallrave dhe shërbimeve.

**Rekomandimi A1** Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.

---

<sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura

<sup>5</sup> Furnizimi me PC (nën 1,000€ për njësi) është paguar në shumë prej 8,572€;  
Furnizimi me Llaptop dhe UPS (nën 1,000€ për njësi) është paguar në shumë 5,913€, (shpenzimi ishte në total 8,931€, mirëpo 3,017€ janë për 3 PC Workstation që janë mbi 1,000€).

### 3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 1,137,867€ me një shpenzim prej 100%. Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrollat që operojnë në nivel të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës kanë të bëjnë me kontrollin e pagesave çdo muaj, verifikimin e ndryshimeve të mundshme, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimin me Thesarin.

Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e pagave nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës dhe lidhur më këtë ne kemi identifikuar si në vijim:

#### Çështja B1 - Kompensimi i shtesave gjatë pushimit të lehonisë

**Gjetja** Ligji i punës, neni 49, përcakton se gjashtë muajt e parë të pushimit të lehonisë, nëpunësja paguhet nga institucioni me kompensim 70% të pagës bazë. Po ashtu me azhurnimin e rregullores për pushime 03/2018 neni 12 pika 2.1, 6 (gjashtë) muajt e parë të pushimit të lehonisë, nëpunësja paguhet nga Gjykata, me kompensim 70% të pagës së nëpunëses.

Në tri raste, kemi identifikuar që me rastin e shfrytëzimit të pushimit të lehonisë, nuk iu është bërë ndalesa e shtesave. Kjo ka ndodh si rezultat që të punësuarave ju kishte përlllogaritur 70% mbi pagën bazë plus shtesa. Për këto raste GJKK kishte paguar 1,430€.

Sipas pohimeve të menaxhmentit, GJKK nuk ka kompetencë në përlllogaritjen e pagës, për këtë GJKK dërgojnë formularin për ndryshime në pagë në MAP, mirëpo në formularin për ndryshime në pagë nuk e specifikohet se shtesat duhet larguar. Për vitin 2019 kjo çështje pritet të rregullohet me ligjin e pagave.

**Rreziku** Mos ndalesa e shtesave gjatë pushimit të lehonisë dhe pagesat e tilla jo në përputhje me vendimet e GJKK-së dhe ligjet në fuqi, rrezikojnë që me rastin e kompensimit të lehonave të dëmtohet buxheti i GJKK-së.

**Rekomandimi B1** Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj vendosjen kontrolleve të shtuara për të parandaluar gabimet e identifikuar në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten. Pagesat e kryera ndaj lehonave duhet të jenë në harmoni të plotë me kërkesat ligjore dhe vendimet përkatëse të GJKK-së.

## Çështja A2 – Mangësi në azhurnimin e kontratave

**Gjetja** Sipas rregullores 07-2010 për emërimet e nëpunësve civil, neni 11- Ndryshimi dhe plotësimi i aktit të emërimit bëhen në një aneks (formulari MAP/AE/02) që i bashkëngjitet Aktit të emërimit në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe akteve tjera nënligjore të Ligjit të Shërbimit Civil.

Gjatë auditimit është vërejtur që në pesë kontrata, paga bazë dallon me pagën bazë në payroll, pasi që nuk ishin bërë ndryshimet në kontratë krahas rritjeve me vendime të Qeverisë<sup>6</sup>. Lidhur me këtë, për vitin 2019 kjo çështje pritet të rregullohet me ligjin e pagave.

GJKK nuk ka bërë ndërhyrje për azhurnim të kontratave krahas rritjeve të pagave, pasi që këto rritje ishin të aplikuara në MAP në sistemin e payrollit. Për këtë, menaxhmenti zotohet se me ligjin e ri të pagave kjo çështje do të rregullohet.

**Rreziku** Mos azhurnimi i kontratave krahas ndryshimeve të pagave nuk paraqet pamje të drejtë të vlerës së kompensimit për punonjësit të cilët kanë kontratë.

**Rekomandimi A2** Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që për ndryshimet e ndodhura në sistemin e pagesave të azhurnohen kontratat. Më tutje, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri të pagave, në periudhën e azhurnimeve të kontratave të reja, të sigurohet se kontratat janë azhurnuar në përputhje me ligjin e pagave.

### 3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë komunalit në vitin 2018 ishte 515,736€. Prej tyre ishin shpenzuar 515,430€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet e udhëtimit zyrtar, shpenzime për shërbime intelektuale dhe përkthime, shpenzime për dreka zyrtare, furnizime për zyrë, shërbime tjera kontraktuese dhe shpenzime të tjera. Në mostrat e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Ne kemi audituar katër kontrata me procedura të prokurimit dhe një kontratë pa procedura të prokurimit. Procedurat e prokurimit ishin zhvilluar në pajtueshmëri me LPP dhe rregullat e udhëzuesit të prokurimit. dhe se nuk kemi çështje për ta trajtuar në këtë kategori.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

<sup>6</sup> Rritja e pagave 25% me vendimin e qeverisë nr.01/176 të datës 10.03.2014 dhe rritja e pagave 4% me vendimin e qeverisë nr.01/24 të datës 12.01.2018.

### 3.1.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 45,211€, ndërsa ishin shpenzuar 44,184€ apo 98%. Këto shpenzime kanë të bëjnë me furnizime për IT, siç janë kompjuter, makina fotokopjuese, softuer dhe pajisje tjera të IT-së.

Përveç testeve substanciale, ne kemi audituar edhe katër kontrata me procedura të prokurimit. Këto procedura ishin zhvilluar në pajtueshmëri me LPP dhe rregullat e udhëzuesit të prokurimit. dhe se nuk kemi çështje për ta trajtuar në këtë kategori.

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Në PFV për vitin 2018, pasuria kapitale mbi 1,000€ ishte në vlerë 78,743€, pasuria jo-kapitale nën 1,000€ ishte në vlerën 34,313€ ndërsa stoqet 10,446€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores MF nr. 02/2013, për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore.

Përveç çështjes së trajtuar në nënkapitullin 2.2, ne nuk kemi identifikuar ndonjë çështje tjetër në këtë fushë.

## 3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 15,117€. Vlera e mbetur si obligim ishte për shkak se, pjesa më e madhe e faturave ishin pranuar në muajin dhjetor 2017. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2019.

Raportimi i obligimeve të papaguara nga GJKK ishte bërë në përputhje me Rregullën Financiare nr. 02/2013 për raportimin e obligimeve të papaguara.

#### **Rekomandimet**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

## 4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollat. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

GJKK në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Qeverisja në GJKK në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. GJKK ka përgatitur regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj si dhe ishte plotësuar pyetësi i vetëvlerësimit. Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre.

#### 4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

GJKK ka një sistem funksional të auditimit të brendshëm si segment i rëndësishëm për të siguruar menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe zbatohen në mënyrën e duhur. Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) përbëhet nga një auditor (Drejtori i NJAB) i cili kishte të aprovuar planin vjetor dhe strategjik. NJAB për vitin 2018 kishte planifikuar dhe kryer katër auditime të rregullta dhe një sipas nevojës me kërkesë të menaxhmentit.

NJAB kishte përmbushur në tërësi planin e auditimit duke dhënë tre rekomandime të cilat ishin zbatuar nga menaxhmenti. Po ashtu, Komiteti i Auditimit në vitin 2018 kishte mbajtur katër takime.

#### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

---

---

## 4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara. Procesi i raportimit të brendshëm funksionon sipas zingjirit llogaridhënës në përputhje me ligjin dhe strukturën organizative. Lidhur me këtë, menaxhmenti mban takime të rregullta me të gjitha departamentet dhe njësitë e saj, çështjet e diskutuara dhe konkluzionet e takimeve ishin pasqyruar në procesverbalet e rregullta.

GJKK ka hartuar regjistrin e rreziqeve duke i identifikuar rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim në arritjen e objektivave. Ky regjistër ishte menaxhuar dhe monitoruar në mënyrë sistematike, si dhe kishte ndërmarrë veprime për të zbutur rreziqet e identifikuara në mënyrë që të mos kenë ndikim negativ në realizimin objektivave të përcaktuara.

### Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të GJKK-së ka rezultuar në dy rekomandime. Lidhur me këto, GJKK kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Nga rekomandimet e dhëna një ishte zbatuar pjesërisht dhe një ishte përsëritur. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shih tabelën 3.

Tabela 3 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Pagat dhe Mëditje	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj vendosjen kontrolleve të shtuara për të parandaluar gabimet e identifikuar në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten. Pagesat e kryera ndaj lehonave duhet të jenë në harmoni të plotë me kërkesat ligjore dhe vendimet përkatëse të GJKK-së.	Ende nuk është zbatuar rekomandimi për kompensimin e pushimit të lehonisë.	I përsëritur
2	Menaxhimi i Pasurisë	Sekretari i Përgjithshëm duhet të bëjë përpjekje që në bashkëpunim me MAP-in të funksionalizohet në mënyrë të plotë sistemi e-pasuria për të mundësuar gjenerimin e raporteve të sakta të pasurisë jo kapitale. Njëkohësisht, të forcoj kontrollet në menaxhimin e pasurisë, duke bërë regjistrimet në kodet e duhura të pasurive në mënyrë që të aplikohen normat e sakta të zhvlerësimit.	Menaxhmenti kishte ndërmarrë veprime të menjëhershme duke bërë kërkesë në MAP për t'i larguar nga regjistri i SIMFK-së të gjithë artikujt të cilët ishin me vlerë nën 1,000€ sipas rekomandimit nga auditimi paraprak. Mirëpo, edhe këtë vit kemi identifikuar dobësi në zhvlerësimin dhe raportimin e pasurive nën 1,000€.	Pjesërisht i zbatuar
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	Kërkesat tjera për raportim	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që me rastin e prezantimit të pasurive jo kapitale nën 1,000€ në PFV-të, përfshihet vlera totale e pasurive të saj duke u siguruar se janë aplikuar normat e zhvlerësimit për të gjitha vitet. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj pasqyrave financiare vjetore janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.		
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.		
3	Paga dhe mëditje	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj vendosjen kontrolleve të shtuara për të parandaluar gabimet e identifikuar në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten. Pagesat e kryera ndaj lehonave duhet të jenë në harmoni të plotë me kërkesat ligjore dhe vendimet përkatëse të GJKK-së.		
4	Paga dhe mëditje	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që për ndryshimet e ndodhura në sistemin e pagesave të azhurnohen kontratat. Më tutje, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri të pagave, në periudhën e azhurnimeve të kontratave të reja, të sigurohet se kontratat janë azhurnuar në përputhje me ligjin e pagave.		

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

### Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe

gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

---

---

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

të përfshihet menjëherë pas opinionit;

të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;

të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe

të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Letërkonfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT  
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 16 maj 2019  
Nr. ref.: SP-906/19/mv

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

#### Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturën dhe rekomandimin dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimit, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tij.

z. Milot Vokshi



Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës